

*Seancës Pleuale*  
*JLS*



**KUVENDI**  
NR 1262 DATE 05.04.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

Nr. \_\_\_ prot.

Tiranë, me \_\_\_/\_\_\_/2024

Lënda: Nisëm për propozimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar"

**KRYETARES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Sh.S. Znj. Lindita Nikolla

**Tiranë**

E nderuar znj. Kryetare,

Mbështetur në nenet 78, 81, pika 1, pika 83 pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, date 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar".

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**Deputetët propozues**

**Etilda Gjonaj**

**Erion Braçe**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_ 2024

**PËR**

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9636, DATË 6.11.2006,  
"PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT", TË  
NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e deputetëve, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9636, datë 6. 1 1.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 8 dhe 10 ndryshohen si vijon:

8. "Reklamim" nënkupton çdo formë të komunikimit tregtar ose jo i tillë me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani;

10. "Sponsorizim" nënkupton çdo formë të kontributit publik ose privat për çdo ngjarje, veprimtari ose individ, me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani.

2. Pas pikës 36 shtohen pikat 37, 38, 39 dhe 40 me këtë përmbajtje:

<sup>1</sup> Ky igj është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/40/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 3 prill 2014, "Mbi përafrimin e ligjit, rregullave dhe dispozitat administrative të shteteve anëtare rreth prodhimit, prezantimit dhe shitjes së duhanit dhe produkteve të duhanit dhe shfuqizimi i Direktivës 2001/37/KE. Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 127/1, datë 29.4.2014, CELEX nr. 32014L0040;
- Direktivën 2003/33/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 Maj 2003 për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe të akteve administrative të Shteteve anëtare, në lidhje me reklamimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit. Fletore zyrtare e Bashkimit Evropian L 152, datë 20.6.2003, p. 16–19, CELEX nr. 32003L003.

37. "duhan" nënkupton gjethet natyrore dhe pjesët e tjera të përpunuara ose të papërpunuara të bimëve të duhanit, duke përfshirë duhanin e homogjenizuar dhe të rindërtuar;

38. "duhan i përtypshëm" nënkupton një produkt duhani pa tym, i destinuar vetëm për qëllime të përtypjes;

39. "produkte duhani për tymosje" do të thotë produkte duhani të ndryshme nga produktet e duhanit pa tym;

40. "produkt bimor për tymosje" nënkupton një produkt të bazuar në bimë, barishte ose fruta që nuk përmban duhan dhe që mund të konsumohet nëpërmjet një procesi djegieje.

## **Neni 2**

Neni 9 ndryshohet si vijon:

### **Neni 9**

1. Ndalohet shitja ose furnizimi, për qëllime tregtimi, i produkteve të duhanit, i cigareve, cigareve elektronike, shishave / nargjileve, dhe të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji, personave nën moshën 18 vjeç.

2. Ndalohet ofrimi falas ose shitja e tyre me ofertë, i produkteve të duhanit, cigareve, cigareve elektronike, shishave / nargjileve, dhe të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji, personave nën moshën 18 vjeç.

3. Të gjitha pikat e shitjes duhet të pajisen me tabelë të dukshme dhe të lexueshme, ku të shkruhet: "Ndalohet shitja e produkteve të duhanit, cigareve elektronike, shishave/nargjileve personave nën 18 vjeç".

### **Neni 3**

Pas nenit 9, shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

#### **Neni 9/1**

**Duhani për përdorim oral**

Ndalohet vendosja në treg e duhanit për përdorim oral.

## **Neni 4**

Neni 10 ndryshon si vijon:

### **Neni 10**

Ndalohet shitja e produkteve të duhanit, cigareve elektronike, shishave/nargjileve dhe të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji:

- a) në institucionet shëndetësore;
- b) në institucionet arsimore;
- c) në institucionet sportive;
- ç) në makinat shitëse automatike;
- d) me anë të vetëshërbimit;
- dh) në rrugë nga shitësit ambulantë;
- e) nëpërmjet shërbimit postar.

#### **Neni 5**

Neni 13 ndryshohet si vijon:

#### **Neni 13**

1. Për duhanin, produktet e duhanit, cigaren, cigaren elektronike dhe për të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 “Përkufizime” të këtij ligji, ndalohe:

- a) reklamimi dhe promovimi, nëpërmjet medias së shkruar, transmetimeve televizive e radiofonike dhe shërbimeve të shoqërive të informacionit,
- b) çdo lloj forme tjetër reklamimi përfshirë promocionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot/stemat e kompanive, ose promocionin nëpërmjet ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm si dhe
- c) për qëllime reklamimi apo promovimi, botimi i fotografive, vizatimeve etj, në të cilat shfaqen persona apo imazhe që krijojnë përshtypje të gabuar te publiku.

2. Nuk përbëjnë reklamim dhe promovim të produkteve të duhanit librat teknikë, revistat dhe botimet e tjera profesionale për duhanin.

#### **Neni 6**

Neni 14 ndryshohet si vijon:

#### **Neni 14**

Për duhanin, produktet e duhanit, cigaren, cigaren elektronike dhe për të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 “Përkufizime” të këtij ligji, ndalohe:

- a) sponsorizimi i medias së shkruar, i programeve radiofonike, televizive, i shërbimeve të shoqërive të informacionit dhe i çdo veprimtarie tjetër nga shoqëri që kanë për objekt të veprimtarisë prodhimin, importimin apo tregtimin e tyre,
- b) sponsorizimi me qëllim promovimin apo reklamin e drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të tyre.

#### **Neni 7**

Neni 20, shkronja b) ndryshohet si vijon:

- b) Shkelja e nenit 9 dënohet me:

i) konfiskim të produkteve të duhanit, cigareve, cigareve elektronike, dhe për të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 “Përkufizime” të këtij ligji, dhe gjobë 200.000 lekë për subjektin shitës me shumicë apo pakicë apo subjektit që e ofron falas sipas kushteve të nenit 9.1 dhe nenit 10;

ii) 500.000 lekë gjobë kur kjo shkelje përsëritet nga subjekti sipas kushteve të nenit 9 dhe nenit 10;

iii) Dyfishim të gjobës së parashikuar në pikën (i) në rastin e shitjes ose ofrimit të cigareve elektronike nën moshën 15 vjeç.

### **Neni 8**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**LINDITA NIKOLLA**

**RELACION  
PËR  
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË LIGJIN NR.9636, DATË 6.11.2006, “PËR MBROJTJEN  
E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT”, TË NDRYSHUAR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji me ndryshimet dhe shtesat e propozuara ka për qëllim mbrojtjen e mëtejshme të shëndetit nga produktet e duhanit në Republikën e Shqipërisë, duke kontribuar në reduktimin e hapësirave ligjore të përdorimit të duhanit dhe produkteve të ngjashme me të.

Këto ndryshime janë mbështetur dhe në raportin<sup>1</sup> e Komisionit Evropian të vitit 2021 mbi efektet e zbatueshmërisë së Direktivës 2014/40/BE, Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 3 prill 2014 “Mbi përafrimin e ligjit, rregullave dhe dispozitat administrative të shteteve anëtare rreth prodhimit, paraqitjes dhe shitjes së duhanit dhe produkteve të duhanit dhe shfuqizimi i direktivës 2001/37/KE, nga i cili rezulton se përdorimi i duhanit gjatë zbatimit të kësaj direktive ka arritur objektivin e reduktimit prej 2% të prevalencës së duhanpirjes tek të rinjtë<sup>2</sup>.

**II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Duhanpirja është një nga faktorët kryesorë të riskut për sëmundjet kronike të cilat janë shkaku kryesor i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në vend. Prevalenca e duhanpirjes ngelet ende e lartë në vendin tonë dhe është e rëndësishme të reduktohet në mënyrë që të ulet numri i personave me sëmundje kronike.

Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij kanë punuar për të reduktuar përdorimin e duhanit dhe produkteve të ngjashme nëpërmjet një sërë masash, duke përfshirë rregullimin ligjor për duhanin dhe produktet e lidhura me të, kufizimin e reklamimit dhe sponsorizimit të duhanit dhe produkteve të ngjashme, caktimin e mjediseve pa duhan dhe zhvillimin e fushatave kundër duhanit. Komisioni Evropian kryen rregullisht sondazhe të opinionit publik për të monitoruar qëndrimet e evropianëve ndaj një sërë çështjesh të lidhura me duhanin. Më pak se një e katërta (23%) e të anketuarve pijnë cigare, puro, puro ose llull, një rënie me tre pikë përqindje që nga viti 2017. 14% e të anketuarve kanë provuar të paktën një ose dy herë cigaren elektronike, ndërsa rreth 1/20 (6%) thonë të njëjtën gjë për produktet e duhanit me ngrohje<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> “EUR-Lex - 52021DC0249 - EN.” EUR-Lex, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52021DC0249>

<sup>2</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52021DC0249> fq. 17

<sup>3</sup> Special Eurobarometer 506: Attitudes of Europeans towards tobacco and electronic cigarettes - Data Europa EU [https://data.europa.eu/data/datasets/s2240\\_506\\_eng?locale=en](https://data.europa.eu/data/datasets/s2240_506_eng?locale=en)

Gjithashtu në opinionin shkencor të SCHEER<sup>4</sup> theksohet se cigaret elektronike përmbajnë nikotinë, një substancë toksike. Opinioni nënvizon pasojat e tyre shëndetësore dhe rolin e rëndësishëm që luajnë në fillimin e pirjes së duhanit.

Rreziku i sëmundjeve kronike fillon herët në fëmijëri dhe një sjellje e tillë vazhdon deri në moshën madhore. Duhani është një substancë që krijon varësi dhe pirja e duhanit shpesh fillon në adoleshencë, përpara zhvillimit të perceptimit të rrezikut. Në momentin kur njihet rreziku për shëndetin, individët e varur e kanë të vështirë të ndalojnë përdorimin e duhanit.

Sipas statistikave të Qendrës Globale për Qeverisjen e Mirë në Kontrollin e Duhanit, deri në vitin 2023, 39 shtete në botë ndalojnë shitjen e cigareve elektronike, 82 shtete lejojnë përdorimin e tyre, por rregullojnë shitjen dhe parashikojnë kufizime në shpërndarje, 38 vende rregullojnë përmbajtjen e nikotinës dhe/ose përbërësve të tjerë në cigaret elektronike, 4 shtete ndalojnë përdorimin e shijeve të caktuara, të shtuara në to.<sup>5</sup>

Sipas një analize krahasimore<sup>6</sup> në vendet Europiane, kryesisht Austri, Çeki dhe Lituani sanksionet në rastin e shkeljes së dispozitave ligjore për të miturit dyfishohen në rastet e përsëritjes. Gjithashtu masa dyfishohet edhe kur shitja ose ofrimi kryhet nfaj një personi nën moshën 15-vjeç (Çekia).

### **Prevalenca e përdorimit të duhanit midis 13-15-vjeçarëve**

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë - Fakulteti i Mjekësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kanë zhvilluar në vitin 2020 anketimin GYTS<sup>7</sup>, mbi përdorimin e duhanit dhe produkteve të tij, tek të rinjtë. Gjithsej 5,388 nxënës të kualifikuar nga klasa 7 deri në 10 kanë përfunduar anketën, nga të cilët 4,052 ishin të moshës 13-15 vjeç. Shkalla e përgjithshme e përgjigjeve ishte 90.4%.

Sipas rezultateve të anketimit rezulton se:

- 15.3% e nxënësve, respektivisht 20.2% e djemve dhe 9.9% e vajzave, përdorin aktualisht produkte të duhanit.
- 14.0% e nxënësve, respektivisht 18.9% e djemve dhe 8.6% e vajzave, pijnë duhan aktualisht.

<sup>4</sup> "Opinion on electronic cigarettes." Public Health - European Commission, 16 April 2021, [https://health.ec.europa.eu/document/download/50b3adac-5451-47c1-8427-ea67e874c970\\_en?filename=scheer\\_o\\_017.pdf](https://health.ec.europa.eu/document/download/50b3adac-5451-47c1-8427-ea67e874c970_en?filename=scheer_o_017.pdf). (Aksesuar për herë të fundit më 1 Prill 2024).

<sup>5</sup> "E-cig Ban and Regulation 2023." GGTC, 12 October 2023, <https://files.ggtc.world/uploads/2023-10-12/14-42-42-138501/E-cig%20Ban%20and%20Regulation%202023.pdf>. (Aksesuar për herë të fundit më 1 Prill 2024).

<sup>6</sup> Analizë krahasuese, Nr. 22/2024, "Rregullimi ligjor i Bashkimit Europian dhe disa shteteve anëtare të tij për cigaret elektronike", Instituti Parlamentar, Kuvendi Republikës së Shqipërisë.

<sup>7</sup> Anketa globale e duhanit për të rinjtë (GYTS), një komponent i Sistemit Global të Mbikëqyrjes së Duhanit (GTSS), është një standard global për monitorimin sistematik të përdorimit të duhanit tek të rinjtë dhe gjurmimin e treguesve kryesorë të kontrollit të duhanit. [https://cdn.who.int/media/docs/default-source/ncds/ncd-surveillance/data-reporting/albania/albania-gyts-2020-factsheet-\(ages-13-15\)-final.pdf?sfvrsn=e5d8e3c0\\_1&download=true](https://cdn.who.int/media/docs/default-source/ncds/ncd-surveillance/data-reporting/albania/albania-gyts-2020-factsheet-(ages-13-15)-final.pdf?sfvrsn=e5d8e3c0_1&download=true) (Aksesuar për herë të fundit më 1 Prill 2024).

- 4.4% e nxënësve, respektivisht 6.4% e djemve dhe 2.4% e vajzave, pijnë cigare aktualisht.
- 2.7% e nxënësve, respektivisht 2.9% e djemve dhe 2.1% e vajzave përdorin aktualisht duhan pa tym

#### **Përdorimi i cigareve elektronike**

- 9.3% e nxënësve, respektivisht 14.2% e djemve dhe 4.1% e vajzave, përdorin cigare elektronike aktualisht.

#### **Aksesi dhe disponueshmëria**

- 68.1% e studentëve që aktualisht pijnë cigare kanë blerë cigare nga një dyqan, shitës ambulant ose kioskë.
- 59.6% e studentëve që aktualisht pijnë cigare, nuk janë penguar për të blerë cigare për shkak të moshës së tyre.

#### **Mediat**

- Më shumë se 5 në 10 (51.1%) nxënës evidentuan mesazhe kundër duhanit në media.
- Më shumë se 3 në 10 (32.4%) studentë evidentuan se reklama apo promovime të duhanit kur vizitonin pikat e shitjes.
- Më shumë se 1 në 10 (12.8%) studentë posedonin një objekt personal me logon e markës së duhanit.

Duhani është shkaku kryesor i shumë vdekjeve që mund të shmangen. Është i vetmi produkt që konsumohet ligjërisht dhe që vret një të tretën deri në gjysmën e atyre që e përdorin. Të rinjtë janë një subjekt i pëlqyeshëm për industrinë e duhanit e cila përpiqet vazhdimisht që të tërheqë konsumatorë të rinj.

Duhani për përdorim oral është lidhur veçanërisht me kancerin e gojës, ezofagut dhe pankreasit, si dhe sëmundjet e zemrës dhe të gojës.

Ashtu si të gjithë produktet e duhanit, duhani për përdorim oral shkakton varësi pasi përmban nikotinë. Disa studime kanë evidentuar se përdoruesit e duhanit oral kanë nivele të nikotines në gjak të krahasueshme me ato të duhanpirësve. Për më tepër mënyrat e ndryshme në të cilat thithet duhani nga përtypja, nënkupton se nikotina mbetet në qarkullimin e gjakut më gjatë se sa tek duhanpirësit.<sup>8</sup>

Nikotina është një substancë që krijon tërheqje të lartë. Për këtë arsye, fëmijët dhe adoleshentët që provojnë duhanin mund të krijojnë varësi shumë shpejt prej tij.

Sipas disa studimeve pjesa më e madhe e njerëzve e fillojnë duhanin përpara moshës 18 vjeç. Afërsisht një e katërta e këtyre të rinjve fillojnë të pijnë duhan para moshës 10 vjeç. Sa më të vegjël të jenë në moshë kur fillojnë të provojnë duhanin, aq më shumë mundësi ka që këta provues të kthehen në duhanpirës të rregullt në të ardhmen.

<sup>8</sup> Il tabacco da masticare è meno dannoso delle sigarette? Fondazione Umberto Veronesi, 27 June 2017, <https://www.fondazioneveronesi.it/magazine/articoli/lesperto-risponde/il-tabacco-da-masticare-e-meno-dannoso-delle-sigarette> (Aksesuar për herë të fundit më 1 Prill 2024).



Është provuar se ekspozimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë ndaj reklamave të duhanit sëbashku me strategji të tjera marketing-u që përdorin industrinë e duhanit, çojnë në rritjen e numrit të të rinjve të cilët pijnë duhan.

Sipas një raporti të ri të publikuar nga "Fushata për Fëmijët pa duhan", kompanitë më të mëdha në botë të duhanit po reklamojnë duhanin dhe produktet e nikotinës për fëmijët në mediat sociale<sup>9</sup>. Publikimet janë parë më shumë se 3.4 miliardë herë në Facebook, Instagram, X (ish Twitter) dhe TikTok. Sipas raportit marketingu i mediave sociale për tre marka është parë nga më shumë se 385 milionë njerëz, duke përfshirë 150 milionë të rinj dhe 16 milionë adoleshentë nën moshën 18 vjeç.

Raporti zbulon një sërë taktikash të përdorura nga kompanitë globale të duhanit për të kontaktuar të rinjtë në internet. Këto taktika përfshijnë marketingun e drejtpërdrejtë të produkteve nga llogaritë e njohura të Instagramit të drejtuara nga kompanitë e duhanit, reklamën me pagesë, konkurset dhe sponsorizimet sportive dhe muzikore.

Shumica e influencer (ndikuesve) (37%) që promovojnë përmbajtje për kompanitë e duhanit janë "kreativë" si muzikantë, DJ, aktorë ose artistë, të ndjekur nga krijuesit e "modës" (30 %). Duhani dhe produktet e nikotinës promovohen gjithashtu nga krijuesit e "lifestyle" (25 %) dhe krijuesit e "sportit" (8%).

Në shkelje të drejtpërdrejtë të politikave të reklamimit të Facebook dhe Instagram, kompanitë e duhanit përdorin reklama me pagesë për të arritur tek të rinjtë në këto platforma.

Raporti dokumenton marrëdhëniet me McLaren, Formula 1, Tomorrowland – një nga festivalet më të njohura të muzikës në botë – dhe Spotify.

### III. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Bazuar në sa më sipër propozohen ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr.9636, datë 6. 1 1.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar, sikurse më poshtë:

#### Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 8 dhe 10 ndryshohen si vijon:

8. *"Reklamim" nënkupton çdo formë të komunikimit tregtar ose jo i tillë me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani;*

10. *"Sponsorizim" nënkupton çdo formë të kontributit publik ose privat për çdo ngjarje, veprimtari ose individ, me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani.*

2. Pas pikës 36 shtohen pikat 37, 38, 39 dhe 40 me këtë përmbajtje:

---

<sup>9</sup> [SponsoredByBigTobacco: Tobacco & Nicotine Marketing on Social Media](#)

37. "duhan" nënkupton gjethet natyrore dhe pjesët e tjera të përpunuara ose të papërpunuara të bimëve të duhanit, duke përfshirë duhanin e homogjenizuar dhe të rindërtuar;

38. "duhan i përtyptshëm" nënkupton një produkt duhani pa tym, i destinuar vetëm për qëllime të përtyptjes;

39. "produkte duhani për tymosje" do të thotë produkte duhani të ndryshme nga produktet e duhanit pa tym;

40. "produkt bimor për tymosje" nënkupton një produkt të bazuar në bimë, barishte ose fruta që nuk përmban duhan dhe që mund të konsumohet nëpërmjet një procesi djegieje.

## **Neni 2**

Neni 9 ndryshohet si vijon:

### *Neni 9*

1. Ndalohet shitja ose furnizimi, për qëllime tregtimi, i produkteve të duhanit, i cigareve, cigareve elektronike, shishave / nargjileve, dhe të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji, personave nën moshën 18 vjeç.

2. Ndalohet ofrimi falas ose shitja e tyre me ofertë, i produkteve të duhanit, cigareve, cigareve elektronike, shishave / nargjileve, dhe të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji, personave nën moshën 18 vjeç.

3. Të gjitha pikat e shitjes duhet të pajisen me tabelë të dukshme dhe të lexueshme, ku të shkruhet: "Ndalohet shitja e produkteve të duhanit, cigareve elektronike, shishave/nargjileve personave nën 18 vjeç".

## **Neni 3**

Pas nenit 9, shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

### *Neni 9/1 Duhani për përdorim oral*

*Ndalohet vendosja në treg e duhanit për përdorim oral.*

## **Neni 4**

Neni 10 ndryshon si vijon:

### *Neni 10*

*Ndalohet shitja e produkteve të duhanit, cigareve elektronike, shishave/nargjileve dhe të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji:*

- a) në institucionet shëndetësore;
- b) në institucionet arsimore;
- c) në institucionet sportive;
- ç) në makinat shitëse automatike;
- d) me anë të vetëshërbimit;
- dh) në rrugë nga shitësit ambulantë;
- e) nëpërmjet shërbimit postar.

#### **Neni 5**

Neni 13 ndryshohet si vijon:

#### **Neni 13**

*1. Për duhanin, produktet e duhanit, cigaren, cigaren elektronike dhe për të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji, ndalohet:*

- a) reklamimi dhe promovimi, nëpërmjet medias së shkruar, transmetimeve televizive e radiofonike dhe shërbimeve të shoqërive të informacionit,
- b) çdo lloj forme tjetër reklamimi përfshirë promocionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot/stemat e kompanive, ose promocionin nëpërmjet ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm si dhe
- c) për qëllime reklamimi apo promovimi, botimi i fotografive, vizatimeve etj, në të cilat shfaqen persona apo imazhe që krijojnë përshtypje të gabuar te publiku.

*2. Nuk përbëjnë reklamim dhe promovim të produkteve të duhanit librat teknikë, revistat dhe botimet e tjera profesionale për duhanin.*

#### **Neni 6**

Neni 14 ndryshohet si vijon:

#### **Neni 14**

*Për duhanin, produktet e duhanit, cigaren, cigaren elektronike dhe për të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji, ndalohet:*

- a) sponsorizimi i medias së shkruar, i programeve radiofonike, televizive, i shërbimeve të shoqërive të informacionit dhe i çdo veprimtarie tjetër nga shoqëri që kanë për objekt të veprimtarisë prodhimin, importimin apo tregtimin e tyre,
- b) sponsorizimi me qëllim promovimin apo reklamimin e drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të tyre.

#### **Neni 7**

Neni 20, shkronja b) ndryshohet si vijon:

- b) Shkelja e nenit 9 dënohet me:

*i) konfiskim të produkteve të duhanit, cigareve, cigareve elektronike, dhe për të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji, dhe gjobë 200.000 lekë për subjektin shitës me shumicë apo pakicë apo subjektit që e ofron falas sipas kushteve të nenit 9.1 dhe nenit 10;*

*ii) 500.000 lekë gjobë kur kjo shkelje përsëritet nga subjekti sipas kushteve të nenit 9 dhe nenit 10;*

*iii) Dyfishim të gjobës së parashikuar në pikën (i) në rastin e shitjes ose ofrimit të cigareve elektronike nën moshën 15 vjeç.*

Propozimet për ndryshime në nenin 1 kanë si qëllim saktësimin e përkufizimeve të koncepteve: "reklamimin" dhe "sponsorizimin" si dhe përfshirjen e këtyre përkufizimeve: "Duhan", "duhan i përtypshëm", "produkte duhani për tymosje" dhe "produkt bimor" për tymosje' në përmbushje të detyrimeve për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian.

Propozimet për ndryshime në nenin 2 kanë për qëllim ndalimin e shitjes, ofrimit falas, apo shitjes me ofertë për të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji për të miturit nën moshën 18-vjeç.

Ndërsa neni 3 ka për qëllim ndalimin e tregtimit të duhanit për përdorim oral, në përmbushje të detyrimeve për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian, sikurse është e sanksionuar për vendet anëtare të BE-së, me përjashtim të Austrisë, Finlandës dhe Suedisë, sipas marrëveshjeve të anëtarësimit në BE, të këtyre vendeve, sepse janë prodhues të këtyre produkteve.

Ndryshimet në nenin 4 ndalojnë shitjen e të gjitha produkteve të parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji në mjediset e përcaktuara në këtë nen.

Ndryshimet në nenet 5 dhe 6 kanë për qëllim ndalimin e reklamimit dhe sponsorizimit për të gjitha produktet e parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji.

Ndryshimet në nenin 7 kanë për qëllim rishikimin e sanksioneve në rastet e shitjes apo ofrimit të gjitha produkteve të parashikuara në nenin 3 "Përkufizime" të këtij ligji për të miturit nën moshën 18-vjeç, si dhe dyfishimin e gjobës në rastet e shitjes apo ofrimit të tyre për të miturit nën moshën 15-vjeç.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar konform neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN**

Ligji 56/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar, është përafuar pjesërisht me :

- **Direktivën 2014/40/BE**, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 3 prill 2014 “Mbi përafrimin e ligjeve, rregullave dhe akteve administrative të shteteve anëtare në lidhje me prodhimin, prezantimin dhe shitjen e duhanit dhe produkteve të ngjashme dhe që shfuqizon Direktivën 2001/37/KE, e ndryshuar.

- **Direktivën 2003/33/KE** e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 Maj 2003 “Mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe akteve administrative të Shteteve anëtare, në lidhje me reklamimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit”, e ndryshuar. Projektligji propozon përafrimin e dy neneve të tij me direktivat e sipërpërmendura.

Projektligji propozon përafrimin e neneve të Ligjit 56/2019 me direktivat e sipërpërmendura.

## **VI. OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM**

Propozimet në këtë projektligj janë konformë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, specifikisht Objektivi 3 “Shëndeti i mirë dhe mirëqenia”, Treguesi 3.4, 3.5 dhe 3.a, si dhe synimet 3.4.1, 3.5.1 dhe 3.a.1.

## **VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit.

DIREKTIVA 2014/40/BE PARLAMENTIT EUROPIAN DHE KESHILLIT		E E		Legjislacioni shqiptar i propozuar: Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar"		
e datës 3 Prill 2014				Shkalla e përafrimit (një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit		
Mbi përafrimin e ligjit, rregullave dhe dispozitat administrative të shteteve anëtare rreth prodhimit, prezantimit dhe shitjes së duhanit dhe produkteve të duhanit dhe shfuqizimi i Direktivës 2001/37/KE				<b>Përputhshmëri e plotë</b> Përputhshmëri e pjesëshme I papërputhur		
Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 127/1, datë 29.4.2014, CELEX nr. 32014L0040						
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
2 (1)	‘tobacco’ means leaves and other natural processed or unprocessed parts of tobacco plants, including expanded and reconstituted tobacco;		Neni 2 pika 2	Pas pikës 36 shtohen pikat 37, 38, 39 dhe 40 me këtë përmbajtje:  37. "duhan" nënkupton gjethet natyrore dhe pjesët e tjera të përpunuara ose të papërpunuara të bimëve të duhanit, duke përfshirë duhanin e homogjenizuar dhe të rindërtuar;	E plotë	
2 (6)	‘chewing tobacco’ means a smokeless tobacco product		Neni 2 pika 2	38. "duhan i përtyphëm" nënkupton një produkt duhani	E plotë	

2 (9)	<p>exclusively intended for the purpose of chewing;</p> <p>‘tobacco products for smoking’ means tobacco products other than a smokeless tobacco product;</p>		Neni 2 pika 2	<p>pa tym, i destinuar vetëm për qëllime të përtypjes;</p> <p>39. “produkte duhani për tymosje” do të thotë produkte duhani të ndryshme nga produktet e duhanit pa tym;</p>	E plotë	
2 (15)	<p>‘herbal product for smoking’ means a product based on plants, herbs or fruits which contains no tobacco and that can be consumed via a combustion process;</p>		Neni 2 pika 2	<p>40. “produkt bimor për tymosje” nënkupton një produkt të bazuar në bimë, barishte ose fruta që nuk përmban duhan dhe që mund të konsumohet nëpërmjet një procesi djegieje;</p>	E plotë	
17	<p><b>Duhani për përdorim oral</b> Shtetet Anëtare duhet të ndalojnë vendosjen në treg të duhanit për përdorim oral, pa cenuar nenin 151 të Aktit të Aderimit të Austrisë, Finlandës dhe Suedisë.</p>		Neni 3	<p>Pas nenit 9, shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:</p> <p style="text-align: center;">Neni 9/1</p> <p><b>Duhani për përdorim oral</b></p> <p>Ndalohet vendosja në treg e duhanit për përdorim oral.</p>	E plotë	

<p>DIREKTIVA 2003/33/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT</p> <p>e datës 26 Maj 2003</p> <p>Për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe të akteve administrative të Shteteve anëtare, në lidhje me reklamimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit.</p> <p>Fletore zyrtare e Bashkimit Evropian L 152, datë 20.6.2003, p. 16–19, <i>CELEX nr. 32003L003</i></p>	<p>Legjislacioni shqiptar i propozuar: Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar"</p> <p>Shkalla e përafrimit (një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit</p> <p>Përputhshmëri e plotë <b>Përputhshmëri e pjesëshme</b> I papërputhur</p>
---	---

1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
2(b)	“Reklamim” nënkupton çdo formë të komunikimit tregtar me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të promovimit të një produkti duhani;		Neni 1 pika 1	Pikat 8 dhe 10 ndryshohen si vijon:  8. “Reklamim” nënkupton çdo formë të komunikimit tregtar ose jo i tillë me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani;	E plotë	



2(c)	<p>“Sponsorizim’ nënkupton çdo formë të kontributit publik ose privat për çdo ngjarje, aktivitet ose individ me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të promovimit të një produkti duhani.</p>		Neni 1 pika 1	<p>10. Sponsorizim’ nënkupton çdo formë të kontributit publik ose privat për çdo ngjarje, aktivitet ose individ, me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani.</p>	E plotë	
------	---	--	---------------	---	---------	--